

**PRAKTIKAT E MIRA RAJONALE MBI
PJESËMARRJEN KOMUNITARE NË
QEVERISJEN VENDORE**

Tiranë 2008

Ky botim është një produkt i Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim i cili realizohet me mbështetjen financiare të Programit East East: Partnership beyond Borders, Program i Rrjetit të Fondacioneve për Shoqëri të Hapur. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura në këtë botim janë të ekspertëve të Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht ato të donatorit.



Punuan për realizimin e botimit:

Erisa Çela, Studiuese Kryesore
Valmir Ismaili, Studiues
Tanja Hafner-Ademi, Studiuese

Përkthyes
Ermira Kuçlar

Adresa: Rr Elbasanit, PO Box 8177, Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 4 340484, Fax: +355 4 347700
E-mail: info@idmalbania.org
www.idmalbania.org

Përmbajtja

Promovimi i Praktikave të Mira Shqiptare mbi Pjesëmarrjen Komunitare

Hyrje.....	10
1.1. Sistemi i Qeverisjes Vendore dhe Legjislacioni Përkatës	12
1.2. Tradita Komunitare Shqiptare	13
1.3 Skema te Mobilizimit te Komunitetit përmes Grupeve me Bazë Komunitare: Praktika e Shkodrës.....	11
1.4 Ngritja e Kapaciteteve për një Qeverisje të Mirë me Pjesëmarrje: Roli i Ndërlidhësit Komunitar në Demokracinë Vendore.....	15
Përfundime	18
Bibliografia	19

Pjesëmarrja dhe mobilizimi i komunitetit në Kosovë

2.1 Sistemi Qeverisës dhe Korniza Ligjore e Kosovës.....	23
2.2 Shoqëria Civile në Kosovë	25
2.3 Korniza teorike	26
2.4 Praktika kosovare e pjesëmarrjes	27
Përfundime dhe rekomandime	30
Bibliografia	31

Praktikat e Mira nga Maqedonia Mobilizimi i Bashkësive dhe Pjesëmarrja e Qytetarëve në Vetëqeverisjen Lokale

Hyrje.....	35
3.1 Raste Studimi të Organizimit Qytetar	35
3.2 Klubi i Personave Handikapë në Dibër	36
3.3 Së shpejti ujësjellës në fshatin Sërbicë.....	36
3.4 Inkuadrimi i qytetarëve në vetëqeverisjen lokale.....	37
Përfundime, leksione të mësuara dhe rekomandime	40

Regional Best Practices on Community Participation in the Local Governance Decision-Making Process

English Summary	45
------------------------------	-----------

PARATHËNIE

Lëmit të gjerë të përpjekjeve për të përforcuar edhe më tej zërin e qytetarëve në vendim-marrje i shtohet sot ky botim përfshirës i praktikave të mira rajonale mbi pjesëmarrjen komunitare në qeverisjen vendore. Ky botim, i pari i këtij lloji përsa i përket mobilizimit komunitar në funksion të një qeverisjeje më demokratike vendore, përfaqëson një nismë rajonale të rëndësishme e cila në pjesën më të madhe kërkon t'i japë shtysë përvojave ekzistuese të suksesshme të anagazhimit qytetar në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni.

Ashtu sikurse mund të nuhatet dhe nga vetë titulli, botimi në vetvete shmang mbështetjen e tepërt mbi rrymat teorike, qoftë sociale qoftë filozofiko-politike të përfshirjes qytetare në vendim-marrje, duke u munduar të sjellë një kurorë përvojash praktike që kanë patur ndikim në ritjen e ndërgjegjësimit e kësisoj edhe angazhimit qytetar në bërjen e axhendave vendore. Nga ana tjetër, nuk mund kurrsesi të pohojmë që evoluimet e ndryshme të pjesëmarrjes qytetare në vendet e mbuluara nga ky botim janë krejtësisht hermetike ndaj shpjegimeve sociale dhe politike. Përkundrazi, dinamikat e çdo procesi të zhvillimit të vetëdijësisë qytetare në këto shtete janë një kombinim i aksiomave teorike dhe kushteve reale për zbatim. Gjithsesi, duke parapëlqyer të jetë mbi të gjitha praktik dhe lehtësisht i kuptueshëm, ky botim është mbi të gjitha një konglomerat përvojash të suksesshme të Shqipërisë, Maqedonisë dhe Kosovës në fushën e pjesëmarrjes komunitare në politikë-bërjen vendore.

E kështu përpos promovimit në nivel rajonal të praktikave të begata të organizimit komunitar në të njëjtën kohë ky botim ngre ndërgjegjësimin e aktorëve dhe vendim-marrësve vendorë si dhe përvjel miratimin e tyre mbi nevojën dhe përfitimet e hartimit të skemave ndërvepruese për pjesëmarrje qytetare. Me këtë sy duhet parë edhe ky botim, si një marrëdhënie e ndërsjellë mes vendeve fqinje për të marrë më të mirën e njëri-tjetrit, për të fuqizuar lëvizjet qytetare në komunitetet e tyre dhe për t'i harmonizuar tempet që ato mbartin në funksion të një demokracie vendore gjithnjë e më të konsoliduar.

Promovimi i Praktikave të Mira Shqiptare mbi Pjesëmarrjen Komunitare

Erisa Çela

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, IDN

Hyrje

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim- IDN¹, prej kohësh tashmë po punon me qeveritë vendore dhe strukturat qytetare kudo nëpër Shqipëri duke ndërmarrë kështu përpjekje serioze për të promovuar pjesëmarrjen qytetare në vendim-marrjen vendore. Duke ndjekur përgatitjen e një baze të veçantë teorike dhe operacionale për hartimin e skemave të posatshme të mobilizimit të komunitetit përmes ngritjes së Grupeve me Bazë Komunitare dhe promovimit të strukturës së Ndërlidhësit Komunitar, IDN po inkurajon qeveritë vendore të ngrenë ura lidhëse ndërvepruese mes tyre dhe vetë komunitetit.

Për më tepër, bazuar në përvojën e deritanishme, hartimi i skemave të pjesëmarrjes dhe mobilizimit komunitar ashtu sikurse dhe mjetet që adresojnë hendekun mes komunitetit dhe qeverisjes vendore janë veçanërisht të dobishme në shoqëritë multi-kulturore dhe multi-etnike, siç është rasti i Kosovës dhe Maqedonisë. Meqenëse këto shtete karakterizohen nga një larmishmëri e lartë popullore me grupime të ndryshme etnike dhe gjuhësore, IDN e konsideron pozicionin e Ndërlidhësit Komunitar por edhe skemat e ndryshme të mobilizimit komunitar përmes grupeve të posatshme si tejet të përshtatshëm për kontekstin e lartpërmendur. Duke synuar promovimin e mëtejshëm të përvojave të mira në mobilizimin dhe pjesëmarrjen e komunitetit si dhe ndërgjegjësimin e aktorëve vendorë vendim marrës në Kosovë, Maqedoni dhe Shqipëri ky publikim paraqet pikë së pari një nismë rajonale, e para e këtij lloji, të ndarjes së praktikave të mira në fushën e pjesëmarrjes aktive qytetare në qeverisjen vendore.

Me qëllim dhënien e një harte të plotë si legjislativë ashtu dhe implementuese, fillimisht kapitulli i parë paraqet terrenin ligjor si dhe sistemin aktual të qeverisjes vendore në Shqipëri, mbi të cilin janë mbështetur nismat e mëvonshme të pjesëmarrjes qytetare. Më pas kapitulli i dytë përpiqet të

1) Për më shumë informacion rreth Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim , ju mund ti referoheni websitit tonë: www.idmalbania.org , ose të na kontaktoni me e-mail: info@idmalbania.org.

përqendrohet në traditën shqiptare komunitare duke synuar të reflektojë impaktin që kjo e fundit ka patur në frymën aktuale të vetë-dijësisë dhe organizimit komunitar.

Grupet me Bazë Komunitare përfaqësojnë një mjet të efektshëm që shpie në qeverisjen me pjesëmarrje si dhe përfshirjen më të gjerë të qytetarëve në politikën vendore dhe proceset përkatës vendim-marrës. Kapitulli i tretë do të paraqesë pikërisht përvojën e IDN-së në këtë fushë dhe ndikimin real që këto grupime komunitare kanë patur në qytetin e Shkodrës. Në fakt duhet shtuar se IDN deri tani ka implementuar në mënyrë të suksesshme projekte të ndryshme të ngjashme në qytete si Laçi apo Bajram Curri. Impakti i suksesshëm i këtyre projekteve ka hapur rrugën për aksione të mëtejshëm nga ana e IDN-së në një përpjekje të mirëfilltë për të rritur mbështetjen publike dhe për të zhvilluar edhe më tej partneritetin me përfaqësuesit e qeverive vendore me qëllim zhvillimin e një demokracie vendore si në Shqipëri ashtu dhe në rajon. Në funksion të qëllimit të këtij botimi përmbledhës gjithsesi ne kemi përzgjedhur të parashtrijmë përvojën e qytetit të Shkodrës si një praktikë të mirë e cila falë indikatorëve të saj të suksesit vlen të ndahet edhe me aktorë të tjerë në Shqipëri e më gjerë.

Ndërkohë kapitulli i katërt dhe i fundit ofron një konspekt të qasjes teorike dhe vepruese të IDN-së lidhur me strukturën e Ndërlidhësit Komunitar. Teorikisht, si një urë lidhëse midis qytetarëve dhe qeverive vendore, kjo strukturë lehtëson jo vetëm mobilizimin e komunitetit por edhe zhvillimin e partneriteve dhe bashkëveprimeve në nivel vendor. Ndërsa praktikisht, ky model po të përshtatet me kontekstet ku aplikohet mund t'u vijë në ndihmë mjaft mirë vetë strukturave vendore por dhe agjencive të tjera të zbatimit të ligjit në përballjen e problematikave të ndryshme sociale, ekonomike dhe kulturore. Ky kapitull i fundit paraqet modelin e promovimit e më pas aplikimit të kësaj strukture në qytetin e Durrësit, një projekt i arritur me kontributin thelbësor të vetë Bashkisë së këtij qyteti.

I.I. Sistemi i Qeverisjes Vendore dhe Legjislacioni Përkatës

Shqipëria aktualisht ndodhet në një proces zbatimi reformash decentralizuese të cilat në vetvete synojnë të bëjnë më të qëndrueshëm sistemin demokratik, të rrisin efektshmërinë qeverisëse, të stimulojnë krijimin e një baze të qëndrueshme për zhvillimin ekonomik, të bëjnë qeverisjen më transparente si dhe të sigurojë pjesëmarrjen e qytetarëve në jetën publike në nivel lokal e rajonal. Në tërësinë e tyre këto reforma nuk mund dhe nuk duhet të konsiderohen si nisma 100% qeveritare, por si reforma që përfshijnë kontributin dhe përvojën e të gjithë aktorëve të përfshirë në proces, si psh qeveria vendore, shoqëria civile, komuniteti ndërkombëtar dhe çka është më e rëndësishme vetë qytetarët.

Para se të kalojmë në legjislacionin përkatës zbatues të reformave të decentralizimit në Shqipëri është mirë të ofrojmë një hartë përshkruese të sistemit aktual të qeverisjes vendore në vend. Sipas *Ligjit nr. 8653, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore të Republikës"*², qeverisja vendore në Shqipëri është e organizuar në dy nivele qeverisjeje. Komunitat dhe Bashkitë janë njësi bazë të qeverisjes vendore dhe përbëjnë nivelin e parë, ndërsa Qarku përbën nivelin e dytë të kësaj qeverisjeje. Njësitë Vendore janë autoritete publike të decentralizuara dhe autonome, përgjegjëse për dhënien dhe shpërndarjen e të mirave dhe shërbimeve publike. Ndërkohë sot në Shqipëri numërohen 304 Komuna, 69 Bashki dhe 12 Qarqe³.

Duke filluar nga viti 2000, realizimi i procesit të decentralizimit është parë i lidhur ngushtë me hartimin e legjislacionit përkatës për të mundësuar transferimin e përgjegjësive nga pushteti qendror drejt qeverisjes vendore. Mes shumë të tjerëve, një ndër aktet më të rëndësishëm ligjorë të miratuar gjatë kësaj periudhe dhe që kanë rëndësi të veçantë për vetë fokusin e këtij studimi është *Ligji nr.8652, i datës 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore"*⁴. Ky ligj dhe aktet e tjera shoqëruese ligjore udhëzojnë decentralizimin e funksioneve nga qeverisja qendrore në qeverisjen vendore duke bërë kështu të mundur kalimin e autoritetit dhe përgjegjësisë për funksione të veçanta tek strukturat vendore⁵. Është pikërisht ky ligji që përcakton autoritetin dhe përgjegjësitë e bashkive dhe komunave në fushat e infrastrukturës dhe shërbimeve publike; shërbimet me karakter social, kulturor e sportiv; si dhe zhvillimin ekonomik vendor.

Në tërësi strategjia e decentralizimit dhe reformat e ndërmarra në kuadër të saj kanë krijuar hapësirat ligjore për pjesëmarrje të gjerë qytetare në vendimmarrje me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimeve në dobi të komuniteteve. Gjithsesi një nga pengesat kryesore në procesin e decentralizimit mbetet forcimi i pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të komuniteteve në qeverisjen vendore. Kjo vjen dhe si rrjedhojë e mungesës së traditës në këtë fushë, çka bëhet dhe më e dukshme nga niveli i ulët i ndjeshmërisë së vetë komunitetit ndaj organeve të qeverisjes vendore dhe mbështetja e vazhdueshme në qeverinë qendrore. Rritja e ndjeshmërisë së komunitetit

2) "Arkiva Shtetërore e Akteve Normativ" Qendra e Publikimeve Zyrtare -QPZ <http://www.qpz.gov.al/results.jsp?simplequerystring=t%C3%AB&page=489>

3) "Strategjia e decentralizimit dhe e qeverisjes vendore" Ministria e Brendshme- MOI <http://www.moi.gov.al/>

4) Bufi, Zana, Vjollca Hysenbegas, dhe Rudina Shiroka. *Legjislacioni Shqiptar 1991-2000: Tregues Bibliografik Tematik. Vellimi 1. Tirane: Kuvendi i Shqiperise, 2001.*

5) Disa prej akteve të tjera më të rëndësishme ligjore të miratuara gjatë kësaj periudhe janë: *Ligji nr. 8653, datë 31.07.2000 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore të Republikës"*, i përmirësuar, *Ligji nr. 8654, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë së Tiranës"*, *Ligji nr. 8743, datë 22.02.2001 "Për pasuritë e paluajtshme të shtetit"*, *Ligji nr. 8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pasurive të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore"*, *Ligji nr. 8978, datë 12.12.2002 "Për taksën vendore të biznesit të vogël"*, i përmirësuar, *Ligji nr. 9232, datë 13.05.2004 "Për programet sociale të strehimit të banorëve të zonave urbane"*, *Ligj nr. 9632, date v30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore".etj.*

si dhe e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të tij në qeverisjen vendore përbën tashmë një objektiv të rëndësishëm të vetë strategjisë së decentralizimit, e cila parashikon nxitjen e rolit të shoqërisë civile nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme, mediave vendore, botimeve, debateve publikë si dhe rritjes së pjesëmarrjes së komunitetit në vendimmarrjen vendore.

1.2. Tradita Komunitare Shqiptare

Por a ka një bazë të mirëfilltë ndjenje komunitare në Shqipëri? Sipas Aleksis de Tokëvil në veprën e tij "Demokracia në Amerikë" emëruesi i përbashkët i çdo organizimi komunitar është gatishmëria për t'u organizuar vullnetarisht dhe për të zgjidhur probleme me interes publik⁶. Nëse këtë përkufizim e përkthejmë në kontekstin shqiptar atëherë lehtësisht arrijmë në konkluzionin që komunitarizmi si një rrymë teorike, qoftë sociale qoftë e lidhur me filozofinë politike nuk ka një traditë të trashëguar në Shqipëri. Gjithsesi organizimi komunitar nuk mund të përmblihet vetëm në përcaktime teorike, ai është njëkohësisht i lidhur edhe me organizimin lokal dhe vetëqeverisjen vendore, me virtytin dhe moralin, me rolin e familjes, të farefisnisë, fqinjësisë, me vullnetarizmin, respektimin e tjetrit e të pasurisë së tij⁷. E parë në këtë këndvështrim mund të themi se në Shqipëri ka patur një traditë të organizimit komunitar, por gjithnjë thjeshtësisht e kufizuar në nivel vendor dhe e mbetur gjithsesi në një fazë të rishtë.

Për më tepër mënyra sesi format e ndryshme të organizimit komunitar u aplikuan në Shqipëri, sidomos në periudhën e sistemit komunist në vend por dhe më pas në atë të tranzicionit e zhveshën atë nga vlerat e mirëfillta të komunitarizmit. Fillimisht në periudhën e sistemit komunist format e organizimit komunitar u ekstremizuan duke e shpërfytyruar vullnetarizmin në një aktivitet të imponuar dhe idenë e kolektivizmit në masivizim të skajshëm⁸. Ndërsa në periudhën që vijoi pas kolapsit të komunizmit, çdo vlerë e ngritur gjatë rendit paraprirës u përball me antagonizmin e skajshëm e gjithpërfshirës të tranzicionit, duke zëvendësuar kështu kolektivizmin esktrim me individualizmin po aq esktrim.

Tanimë Shqipëria ndodhet në një fazë të ri-organizimit komunitar, ku sipas kontekstin aktual të karakterizuar nga migrimi i brendshëm e në masë, përparësi marrin elementë të tjerë specifikë siç janë fqinjësia, njësitë prodhuese apo të shërbimit, grupet e interesit⁹, shoqata, grupimet e ndryshme tematike dhe gjeografike të shoqërisë civile, etj. E kuptuar kështu, mund të themi se tanimë në Shqipëri është shtruar infrastruktura e nevojshme për

6) De Tocquevill, Alexis. Demokracia në Amerikë. http://xroads.virginia.edu/~HYPER/DETOC/toc_indx.html

7) Sokoli, Leke. "Komunitarizmi, modelet e organizimit dhe Ndërlidhësit Komunitarë" ne Ndërlidhësi Komunitar në Demokracinë Vendore. Tirane: Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim: 2006

8) Idem

9) Sokoli, Leke. "Komunitarizmi, modelet e organizimit dhe Ndërlidhësit Komunitarë" ne Ndërlidhësi Komunitar në Demokracinë Vendore. Tirane: Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim: 2006

krijimin e kushteve për mobilizim komunitar. Gjithsesi, sfida kryesore mbetet ndryshimi i mendësisë lidhur ngushtë me individualizmin si një kundërveprim ndaj çdo akti vullnetar dhe gatishmërie për angazhim të përbashkët qytetar në dobi të së mirës së përgjithshme.

1.3 Skema te Mobilizimit te Komunitetit përmes Grupeve me Bazë Komunitare: Praktika e Shkodrës

Për aplikimin e një qeverisjeje të mirë vendore është pikë së pari e nevojshme një përfshirje e gjerë dhe serioze e komunitetit në procesin e vendim-marrjes. Në ambientin shqiptar, kjo përjasje kthehet në një domosdoshmëri, nëse do të merrnim parasysh legjitimitetin e trashëguar nga një mendësi e vjetër shoqërore ku tradita demokratike ka munguar dhe aktualisht gjendet në hapat e parë e të brishtë të zhvillimit të saj. Pra, në një kontekst ku konsolidimi i institucioneve demokratike politikë-bërëse mbetet ende një sfidë dhe performanca e tyre ende e dobët, përfshirja përmes modeleve të posatshtëm, e vetë qytetarëve në vendim-marrje, jo vetëm do të rriste transparencën e strukturave vendore në sytë e publikut por do të thyente stereotipet e deritanishme mbi strukturat qeverisëse vendore dhe mungesën e besimit kundrejt tyre nga ana e qytetarëve.

IDN prej kohësh ka qenë i angazhuar në përafrimin e strukturave të qeverisjes vendore me shqetësimet e qytetarëve në dobi të krijimit të një ambienti më të mirë bashkëjetues me vlerat e mirëfillta të një demokracie vendore. Një përpjekje serioze dhe dëshmuese e kësaj përjasje është dhe puna e deritanishme që IDN ka ndërmarrë në qytetin e Shkodrës. Përmes ndihmës së çmuar të Ndërlidhësve Komunitarë Lokalë, IDN ka promovuar në këtë qytet përvojën e tij të mobilizimit të komunitetit. Fillimisht, kjo lloj qasje krejt e re e nxitjes së qytetarëve u zhvillua në rajonet nr. 2 dhe 3 të qytetit të Shkodrës me anë të ngritjes dhe operimit të 5 Grupeve me Bazë Komunitare të cilët kanë qenë mëse aktivë në 2 vitet e fundit në qytet dhe kanë ndihmuar jo vetëm në afrimin e problemeve të komunitetit pranë vëmendjes së strukturave vendore por edhe kanë bashkëpunuar me këto struktura për realizimin e projekteve të përbashkëta me qëllim përmirësimin e jetës së komunitetit.

Por si mund të përkufizohen konkretisht këto grupe me bazë komunitare dhe cili është emëruesi i përbashkët i pjesëtarëve përbërës të këtyre grupeve? Bazuar në përvojën e Shkodrës, grupet me bazë komunitare në komunitetin e Badra dhe Gjuhadol mbledhin brenda vetes individë apo grupe me bazë laqjeje të cilët përveç se ndajnë të njëjtin vizion për rolin e rëndësishëm të komunitetit në zhvillimin e zonës ku banojnë, zgjidhen në mbledhje të hapura nga vetë komuniteti duku u bërë kështu përfaqësues dhe tejçues të zërit të komunitetit. Misioni themelor i këtyre grupeve është ngritja e ndërgjegjes komunitare, si dhe organizimi i komunitetit në marrjen e përgjegjësisë vetjake për një jetë normale qytetare. Në këtë mënyrë ata vetvetiu kthehen

në përfaqësues të fjalës së komunitetit pranë organeve të zgjedhura politike, rajonale dhe qendrore.

Aktivitetet që këto grupe vullnetare kryejnë janë të larmishme dhe mbulojnë një gamë të gjerë problematikash të lidhura me komunitetin dhe zonën ku ata banojnë. Disa prej aktiviteteve më të rëndësishme që këto grupe kryejnë janë organizimi i takimeve me përfaqësues të institucioneve në nivel vendor; negocimi e më pas arritja e marrëveshjeve të ndryshme të mirëkuptimit me këto institucione për çështje prioritare të komunitetit; tryeza të rumbullakta me përfaqësues të zbatimit të ligjit për të krijuar lidhje bashkëpunimi; si dhe aktivitete të ndryshme sociale kulturore dhe artistike me grupe të ndryshme shoqërore si psh të rinjtë, familjet në nevojë, moshën e tretë, etj. Tashmë një Memorandum Mirëkuptimi dhe Partneriteti është vendosur mes Bashkisë së Shkodrës dhe këtyre grupeve duke zhvilluar kështu një ndjenjë të fortë vetë-dijësie dhe përkatësie të komunitetit në këto zona.

Gjithsesi, dobia e kësaj përvoje mobilizimi qytetar nuk kufizohet vetëm në urën lidhëse që ka krijuar mes komunitetit dhe strukturave vendore, duke e bërë komunitetin pjesë aktive të vendim-marrjes, por mbi të gjitha ka lëvruar terrenin për vetëdijësi qytetare, zgjim nga letergjia pasive që karakterizonte më parë komunitetin teksa vendime të rëndësishme e jetike merreshin pa konsultime të gjera me të. Nga ana tjetër, përmes trysnisë pozitive të këtyre nismave komunitare, vetë strukturat e qeverisjes vendore ndjejnë se janë më në kontakt me zërin e komunitetit, çka i mundëson të jenë më të përgjegjshëm në proceset e përpilimit të strategjive lokale dhe planifikimeve urbane në përgjithësi. Një rast për t'u përmendur është ngritja e një qendre të vetme koordinative për të gjithë qytetin e Shkodrës. Vetë nxitja e grupeve me bazë komunitare të rajonit nr. 2 shpunë në ofrimin ambjentëve pranë zyrave të Bashkisë nga ana e vete Bashkisë për hapjen dhe funksionimin e qendrës.

Për më tepër falë përvojës së punës së përbashkët me IDN dhe komunitetin dhe ndërgjegjësimit mbi rëndësinë dhe dobitë e mobilizimit komunitar Bashkia e Shkodrës ka aprovuar në buxhetin e saj për vitin 2008 një buxhet të posaçëm, i pa aplikuar më parë, caktuar për nxitjen e pjesëmarrjes qytetare në zhvillimin e komunitetit nëpërmjet aktiviteteve dhe projekteve komunitare. Prania e vazhdueshme e IDN-së përmes aktiviteteve të ndryshme në Shkodër si dhe impakti pozitiv që këto aktivitete të mobilizimit komunitar dhe qeverisjes me pjesëmarrje kanë patur, ka rritur ndjeshëm ndërgjegjësimin e autoriteteve vendore, strukturave policore, institucioneve të zbatimit të ligjit, shoqërisë civile, biznesit dhe vetë komunitetit për shtrirjen e organizimit komunitar edhe në rajonet e tjera të qytetit të Shkodrës. Në fakt, qëndrimi aktual inkurajues i të gjithë këtyre aktorëve kanë bindur IDN –në për nevojën e zhvillimit të një përkushtimi afatgjatë e të qëndrueshëm dhe përfshirje më të madhe të agjencive të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare.

IDN ka ofruar dhe vazhdon të ofrojë mbështetje administrative dhe financiare për funksionimin e qendrës komunitare sot dhe jep ekspertizën e saj për ngritjen e kapaciteteve të grupeve komunitare, stafit të qendrës

komunitare dhe grupeve të ndryshme të interesit. Një nga pikat më të rëndësishme të ngritjes së kapaciteteve të grupeve komunitare ka qenë edhe fuqizimi i këtyre të fundit për të ngritur fonde të tyre të pavarura. Gjithsesi duhet theksuar se sfida kryesore e përvojës së deritanishme në mobilizimin e komunitetit për një vendim-marrje më aktive në çështjet e komunitetit mbetet konsolidimi i saj dhe shndërrimi në një instrument të qëndrueshëm çka mund të arrihet vetëm përmes hartimit të partneriteteve me aktorë të tjerë përtej strukturave të qeverisjes vendore, si psh sektori i biznesit apo institucionet dhe organizatat e ndryshme ndërkombëtare që operojnë në Shkodër. Ngritja e më pas konsolidimi i këtyre partneriteteve tre-palëshe me përfaqësim të gjerë të të gjithë grupeve të interesit, jo vetëm që do të mbante gjallë frymën e re të pjesëmarrjes qytetare shkodrane në vendim-marrjen vendore por do të përmirësonte ndjeshëm standardet e jetesës për të gjithë qytetin.

1.4 Ngritja e Kapaciteteve për një Qeverisje të Mirë me Pjesëmarrje: Roli i Ndërlidhësit Komunitar në Demokracinë Vendore

Prej më se tre vitesh ideja mbi rolin e Ndërlidhësit Komunitar në demokracinë vendore ka qenë pjesë e rëndësishme e objektivave të IDN-së për të sensibilizuar dhe integruar vëmendjen e të gjithë aktorëve në nivel vendor e kombëtar në vlerësimin dhe ri-dimensionimin e kësaj strukture me qëllim përballjen e sfidave të reja të realitetit shqiptar në nivel komunitar. E parë në këtë trajtë, pjesëmarrja qytetare në vendim-marrjen e të gjitha niveleve, partneriteti qytetar në zbatimin e ligjit në të gjitha fushat e aktivitetit shoqëror si dhe krijimi i forumeve qytetare mbeten mekanizma shoqërorë të rëndësishëm për stabilizimin social dhe përmirësimin e qeverisjes. Tashmë problematikat e pazgjidhura në demokracinë e nivelit komunitar kanë nisur të pjekin mendimin e të gjithëve se jo gjithçka duhet pritur nga lart dhe se përgjegjësitë duhen marrë duke filluar që nga mjediset më të vogla të çdo bashkie e komune.

Duke ndjekur përgatitjen e një baze unike teorike dhe funksionale mbi rolin e Ndërlidhësit Komunitar si një strukturë efektive që përfshin qytetarët në bërjen e axhendave, departamenti i IDN-së mbi mobilizimin lokal dhe decentralizimin, në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme të Shqipërisë po inkurajon më tej qeverinë vendore të institucionalizojë Ndërlidhësin Komunitar si një strukturë lidhëse mes qytetarëve dhe qeverisë vendore me qëllim mobilizimin dhe organizimin komunitar si dhe zhvillimin e partneriteteve dhe ndërveprimit lokal.

Bazuar në legjislacionin tonë për qeverisjen vendore është në kompetencë të organeve të qeverisjes vendore për të ngritur elementë të ndryshëm strukturorë, si dhe për të vendosur raporte të qarta komunikimi në mes tyre

kur gjykohet e nevojshme. E në fakt Ndërlidhësi Komunitar¹⁰ shërben si një instrument për të mbështetur organet e qeverisjes vendore për zbatimin e akteve ligjore e nënligjore, në territorin ku ato veprojnë. Gjithsesi Ndërlidhësi nuk duhet konceptuar si personi që kryen gjithçka, apo zëvendëson institucione të tjera. Ai shërben si një strukturë lehtësuese, nxitëse, mbështetëse, informuese e orientuese për të përmirësuar zbatueshmërinë e të gjithë komponentëve ku ligji organik i pushtetit vendor apo i institucioneve të tjera në nivel vendor kërkojnë përfshirjen apo mbështetjen komunitare. Misioni i tij është të përfaqësojë zërin e komunitetit në vendim-marrjen vendore: të përmirësojë komunikimin reciprok mes organeve në nivel vendor dhe komunitetit; si dhe të zhvillojë partneritete mes strukturave vendore vendim-marrëse dhe zbatuesve të ligjit në nivel komuniteti.

Në fakt ky model është tashmë operacional në Bashkitë e Tiranës dhe Shkodrës. Gjithsesi sipas një hulumtimi të kryer nga IDN mbi këtë strukturë në vitin 2007, rezulton se:

- Qytetarët nuk e njohin mjaftueshëm këtë strukturë;
- Caktimi i tyre kryhet mbi baza përkatësish politike apo motive klienteliste;
- Nuk kanë një përshkrim të qartë pune;
- Nuk kanë kapacitete dhe njohuri për të ndërvepruar me komunitetin e më tej;

Ndërsa në qytetin e Durrësit IDN po kryen një përfaqëse krejt inovatore si në promovimin ashtu dhe fuqizimin e strukturës së Ndërlidhësit. Që prej dy vjetësh IDN ka nisur procesin e ndërgjegjesimit rreth kësaj strukture në qytetin e Durrësit duke kryer disa takime me drejtuesit lokalë të Bashkisë së Durrësit për t'i informuar dhe për t'i kthyer në aleatë në këtë sipërmarrje. Pas takimeve të ndryshme individuale dhe në grup me aktorët kryesorë të vendim-marrjes vendore por edhe pjesëtarë të institucioneve të tjera ligjvënëse, u arrit konsensusi që në buxhetin e Bashkisë së Durrësit për 2008 të parashikohet ngritja dhe funksionimi i strukturës së Ndërlidhësit Komunitar.

Ndryshe nga procedura aktuale e përzgjedhjes dhe emërimit të kësaj strukture në Bashkitë e Tiranës dhe Shkodrës, këtë herë IDN dhe Bashkia e Durrësit arritën në vendimin konsensual që Ndërlidhësit Komunitarë të përzgjidheshin dhe propozoheshin nëpërmjet pëlqimit publik dhe propozimeve të qytetarëve, për t'u emëruar më pas nga Këshilli Bashkiak. E në fakt, sa më demokratike të jetë procedura e emërimit të Ndërlidhësve Komunitarë, sa më përfshirës të jetë komuniteti i banorëve në përzgjedhjen e tyre, sa më i angazhuar të jetë organi përfaqësues i pushtetit vendor (këshilli i bashkisë apo komunës), aq më i suksesshëm dhe i realizueshëm do të jetë

10) Drejtori Ekzekutiv i IDN-së dhe Zëvendës/ministri i Brendshëm i Shqipërisë kanë firmosur një letër të për-bashkët e cila i udhëzon përfaqësuesit e qeverisë vendore të përfshijnë strukturën e Ndërlidhësit Komunitar në organigramën e tyre.

roli i Ndërlidhësit Komunitar në demokracinë vendore. Tashmë Ndërlidhësit Komunitarë janë përzgjedhur e propozuar nga komuniteti i qytetit të Durrësit, pritet të emërohen prej Këshillit Bashkiak dhe së shpejti do të kryejnë rolin e tyre lidhës mes komunitetit dhe strukturave të qeverisjes vendore të Durrësit.

Por si matet realisht performanca e strukturës së Ndërlidhësit Komunitar dhe ç'rol konkret mund të marrë kjo strukturë e sapo krijuar në qytetin e Durrësit. Dhe çka është më e rëndësishme për këtë raport praktikash të mira si mund të kontribuojë kjo strukturë edhe në kontekste multi-kulturore dhe multi-etnike siç është rasti i Maqedonisë dhe Kosovës. Bazuar në formulimin teorik të IDN-së mbi rolin dhe detyrat e Ndërlidhësit Komunitar në demokracinë vendore por dhe duke marrë parasysh terrenin ku ky model është aplikuar dhe do të aplikohet Ndërlidhësi Komunitar shihet si një strukturë e cila:

- **lehtëson** punën e institucioneve vendore për të organizuar takime aktive me banorët për tërheqjen e mendimeve për probleme të tilla si buxhetimi me pjesëmarrje, përcaktimi i prioriteteve në shërbime dhe investime, planifikimi urban, mjedisi ,furnizimi me ujë, arsimit etj
- **mundëson** që propozimet e tyre të paraqiten për miratim në organet përkatëse kompetente.
- **evidenton , informon dhe mbështet** strukturat e caktuara kompetente në rastet e ndërhyrjeve të paligjshme në infrastrukturën publike dhe mobilizon e organizon aktivistë qytetarë për të ndihmuar në zgjidhjen e problemeve.
- **ndihmon** në mos lejimin e tregtimit ambulant në vende publike të paligjshme dhe në vendosjen e gjobave përkatëse mbështetur në aktet e nxjerra nga organet kompetente të qeverisjes vendore
- **ndihmon** në verifikimin dhe saktësimin e informacionit në fushën e gjendjes civile, mobilizimin ushtarak sigurimin e kushteve të infrastrukturës në zgjedhjet parlamentare apo vendore si dhe në referendume dhe ndjek respektimin e rregullave të vëna për këtë qëllim nga organet e qeverisë.
- **lehtëson** punën në administratën tatimore të bashkisë për evidentimin e saktë të subjekteve taksapagues, jep kontributin në vjeljen të ardhurave nga taksat vendore në bashkëpunim me organet kompetente vendore
- **bashkëpunon** (kur i kërkohet) dhe ndihmon organet e policisë së shtetit dhe policisë bashkiake në fushën e ruajtjes së rendit dhe të qetësisë publike. Bashkërendon me inspektorin e rendit publik në zonë për çështje të parandalimit të krimit dhe të bashkëpunimit me komunitetin.
- **bashkëvepron** me strukturat vendore në fushën e kujdesit dhe përkrahjes sociale dhe informon ato në veçanti në lidhje me rastet e verifikuara për ata që përfitojnë ndihmë ekonomike, që përfshihen

në projekte të punëve publike, të familjeve në nevojë, të rasteve që kërkojnë trajtim të veçantë në kuadër të kujdesit social etj.

- **lehtëson** kontakte dhe nxit procese konsultimi me banorët për përcaktimin e prioriteteve të komuniteteve vendore gjatë procesit të përgatitjes së buxheteve vendore.

Përmes punës së vazhdueshme në promovimin e strukturës së Ndërlidhëit Komunitar IDN kërkon të institucionalizojë një praktikë që në plan afatgjatë do të adresonte mjaft sfida të komunitetit dhe strukturave vendore. Praktika e funksionimit të kësaj strukture në Tiranë dhe Shkodër gjithsesi ka dëshmuar se standardizimi i detyrave funksionale të kësaj strukture në të gjithë komponentët e jetës komunitare do të sillte një formë të ekuilibruar të pozicionimit të kësaj strukture midis pushtetit vendor dhe komunitetit. Gjetja e një ekuilibri të tillë mbetet një çështje e rëndësishme që në radhë të parë ka të bëjë me konceptin demokratik të pjesëmarrjes dhe axhendën politike të vendim-marrësve në çdo nivel të organizimit të pushtetit.

Përfundime

Ky botim, përfaqëson një nismë rajonale e cila në vetvete synon promovimin e praktikave më të mira të IDN-së në fushën e pjesëmarrjes komunitare dhe qeverisjes vendore me pjesëmarrje përmes Grupeve me Bazë Komunitare dhe strukturës së Ndërlidhësit Komunitar. Përgjatë viteve të fundit janë implementuar projekte të ndryshme mbi këtë problematikë dhe përvoja e deritanishme ka dëshmuar se strukturat komunitare janë thelbësore në arritjen e një impakti të qëndrueshëm gjatë ngritjes së qeverisjes me pjesëmarrje. Në veçanti përvoja e Shkodrës, përmes grupeve me bazë komunitare dhe ajo e Durrësit përmes Ndërlidhësve Komunitarë, ofron një model të shëndoshë mbi mënyrën sesi komuniteti mund të ndërveprojë me qeverinë vendore, si t'i sjellë problemet e qytetarëve pranë vëmendjes së autoriteteve vendore dhe si të ndikojë në procesin lokal të bërjes së axhendave.

Skemat shqiptare të pjesëmarrjes dhe mobilizimit komunitar të paraqitura në këtë botim janë mjete të efektshme për të adresuar e më pas afruar hendekun që ekziston së shumti mes komunitetit dhe qeverisjes vendore, e si të tilla janë veçanërisht të dobishme në shoqëritë multi-etnike, siç është rasti i Kosovës apo Maqedonisë. Meqënëse këto dy shtete karakterizohen nga një larmishmëri e lartë popullore me grupe të ndryshme etnike dhe gjuhësore, skemat e përbashkëta mobilizuese të komunitetit dhe zhvillimi i parteriteteve të ndërsjellëta bëhen tejet të përshtatshme për kontekstet e shpjeguara më lart. Këto skema dhe strukturat që ngrihen përmes tyre shërbejnë jo vetëm për të lehtësuar komunikimin Komunitet-Qeveri Vendore-Biznes, por gjithashtu

në shoqëritë multi-etnike mund të shërbejnë edhe për të reduktuar konfliktin dhe përmirësuar vënien në fuqi të ligjit. Me këtë sy duhet parë edhe ky botim, i pari i këtij lloji përsa i përket ndarjes së praktikave më të mira të mobilizimit komunitar në një nivel rajonal, si një mësim i ndërsjellë mes fqinjësh, si një punë e përbashkët mes aktorëve homologë vendorë për të zhvilluar dhe zgjeruar më tej në rajon modele origjinale të pjesëmarrjes komunitare.

Bibliografia

-“Arkiva Shtetërore e Akteve Normativ” Qendra e Publikimeve Zyrtare -QPZ
<http://www.qpz.gov.al/results.jsp?simplequerystring=t%C3%AB&page=489>

-Bufi, Zana, Vjollca Hysenbegas, dhe Rudina Shiroka. Legjislacioni Shqiptar 1991-2000: Tregues Bibliografik Tematik. Vëllimi 1. Tirane: Kuvendi i Shqipërisë, 2001.

-De Tocquevill , Alexis. Demokracia në Amerikë. http://xroads.virginia.edu/~HYPER/DETOC/toc_indx.html

-Sokoli, Leke. “Komunitarizmi, modelet e organizimit dhe Ndërlidhësit Komunitarë” ne Ndërlidhësi Komunitar në Demokracinë Vendorë. Tirane: Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim: 2006

-“Strategjia e decentralizimit dhe e qeverisjes vendorë” Ministria e Brendshme- MOI <http://www.moi.gov.al/>

Pjesëmarrja dhe mobilizimi i komunitetit në Kosovë

Valmir Ismaili

Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave, KIPRED

2.1 Sistemi Qeverisës dhe Korniza Ligjore e Kosovës

Kosova ka deklaruar pavarësinë e saj me 17 shkurt 2008. Deri më tani Kosovën e kanë njohur 43 shtete tjera, përfshirë edhe shtetet më të forta në botë si SHBA, Angli, Francë, Gjermani dhe Itali. Deklarata e Pavarësisë si dhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës, tashmë e miratuar dhe që pritet të hyjë në fuqi shumë shpejt, gjerësisht i janë përshtatur planit të Ahtisarit. Megjithëse ka shpallur pavarësinë e saj, sipas planit të Ahtisarit, Kosova do të vazhdojë të ketë një mision ndërkombëtar me fuqi supranacionale, Zyrën Ndërkombëtare Civile (ICO) e po ashtu edhe një formë të ndryshuar të misionit aktual të UNMIK-ut.

Para 17 shkurtit, Kosova ka qenë e administruar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), mision ky i bazuar në rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Pushtetet e përqendruara në duart e UNMIK-ut në mënyrë të vazhdueshme janë transferuar te Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës që tashmë njihen si institucionet e Republikës së Kosovës. Kompetencat të cilat janë duke u transferuar më së voni janë kryesisht në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe sigurisë.

Republika e Kosovës sipas Kushtetutës së miratuar, që hyn në fuqi me 15 qershor të këtij viti, ka sistem qeverisës që mund të quhet si republikë parlamentare me president të fuqishëm. Sistemi kosovar i qeverisjes është i ndarë në tri degë: Ekzekutiv, Legjislativ dhe Gjyqësor. Prezenca ndërkombëtare aktuale dhe ajo që parashihet të jetë në të ardhmen dikton ndarjen e pushtetit në mes të vendorëve dhe ndërkombëtarëve. Në njërën anë qëndrojnë institucionet e Republikës së Kosovës e në tjetrën ICO dhe UNMIK-u. Në aspektin e pushtetit lokal Kosova ndahet në 30 komuna të cilat ushtrojnë pushtetet që nuk ushtrohen nga niveli qendror. Komunat e kanë asamblenë e vet si dhe kryetarin ku qytetarët zgjedhin në mënyrë të drejtpërdrejtë secilin nga këto organe.

Pa marrë parasysh mënyrën e interpretimit, pushteti ekzekutiv në Kosovë ushtrohet nga Qeveria e Kosovës e përbërë nga gjashtëmbëdhjetë ministra dhe Zyra e Kryeministrit. Përbërjen e ministrive dhe ministrave e dikton Korniza Kushtetuese, ndërsa pas 15 qershorit 2008 Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Pushteti i legjislativit në Kosovë ushtrohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës i cili është monokameral dhe përbëhet nga 120 deputetë. Nga këto 120 ulëse, 20 janë të rezervuara për pakicat etnike, përkatësisht 10 për komunitetin etnik serb dhe 10 për komunitetet tjera.

Dega e gjyqësorit deri më tani ka qenë në kompetenca të përbashkëta të institucioneve kosovare dhe të UNMIK-ut që kanë përfshirë gjykata të niveleve të ndryshme nga gjykata komunale, e kundërvajtjes, gjykata e qarkut deri të gjykata supreme. Sistemi aktual gjyqësor përfshin edhe njësinë që ekzaminon kompetencën dhe sjelljet e mundshme jokorrekte të gjyqtarëve që deri tash ishte kompetencë ekskluzive e UNMIK-ut. Me kushtetutën e re pritet që kjo degë të jetë plotësisht e drejtuar nga institucionet vendore por e monitoruar dhe ndihmuar nga misioni i EULEX-it.

Niveli lokal i sistemit qeverisës është i deleguar tek komunat. Deri më tani pushteti lokal është i bazuar në kornizën ligjore sipas rregullore administrative të UNMIK-ut 2000/45 e cila është ndryshuar me rregulloren tjetër 2007/30. Sipas nenit 3 të kësaj rregulloreje, komunat janë përgjegjëse për këto aktivitete vijuese:

- (a) Ofrimin e kushteve themelore lokale për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik;
- (b) Planifikimin urban dhe të fshatit dhe shfrytëzimin e tokës;
- (c) Lëshimin e lejeve për ndërtim dhe zhvillime të tjera;
- (d) Mbrojtjen lokale të ambientit;
- (e) Zbatimin e rregullave të ndërtimit dhe kontrollimin e standardeve të ndërtimit;
- (f) Ofrimin e shërbimeve publike lokale dhe të infrastrukturës duke përfshirë furnizimin me ujë, ujësjellësin dhe kanalizimin, përpunimin e ujerave të zeza, mirëmbajtjen e rrugëve lokale, transportin lokal dhe planet për ngrohtoret lokale;
- (g) Shërbimet publike duke përfshirë shërbimin e zjarrfikësve dhe të emergjencës;
- (h) Menaxhimin e pronës komunale;
- (i) Edukimin parashkollor, fillor dhe të mesëm;
- (j) Kujdesin shëndetësor primar;
- (k) Shërbimet sociale dhe strehimin;
- (l) Mbrojtjen e konsumatorëve dhe shëndetin publik;
- (m) Lëshimin e lejeve për shërbime dhe pajisje, duke përfshirë argëtimin, ushqimin, tregjet, shitjet në rrugë, transportin publik lokal dhe shërbimin e taksistëve, gjuetinë e peshkimit, restorantet dhe hotelet;
- (n) Panairet dhe tregjet;
- (o) Emërimin dhe riemërimin e rrugëve dhe vendeve të tjera publike;
- (p) Sigurimin dhe mirëmbajtjen e parqeve publike, hapësirave të hapura dhe varrezave dhe;
- (q) Aktivitete tjera të ngjashme të nevojshme për administrimin adekuat të komunës, që nuk janë të përcaktuar gjetiu me ligj.

Përveç aktiviteteve të sipërpërmendura, komunat mund të ndërmarrin edhe veprime tjera në territorin e tyre. Këto veprime kryesisht kanë të bëjnë me turizmin, aktivitetet kulturore, sportet dhe aktivitetet e lira, aktivitetet e rinisë, avancimin e ekonomisë, avancimin e vlerave qytetare, etj. Neni 5 i kësaj rregulloreje u mundëson fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve

që të ushtrojnë vetë apo në grupe aktivitetet që janë në përgjegjësi dhe kompetencë të komunës. Në raste të tilla fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane marrin fonde përkatëse nga komuna. Statutet e komunave janë ato të cilat e përcaktojnë formën e bashkëpunimit ndërmjet komunës, fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane lidhur me vëllimin e punës, organizimin e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.

Për herë të parë në zgjedhjet e fundit të vitit të kaluar kryetarët e komunave u zgjodhën me votën e drejtpërdrejtë të qytetarit dhe në një mënyrë u bë ndarja e pushtetit ekzekutiv me atë legjislativ në nivel komunal.

2.2 Shoqëria Civile në Kosovë

Shoqëria kosovare nuk trashëgon ndonjë të kaluar të pasur për sa i përket aktivizimit dhe pjesëmarrjes së shoqërisë civile në aktivitete të ndryshme. Në një raport të UNDP-së të vitit 2004 thuhet se qytetarët në Kosovë marrin pjesë katër herë më shumë në forma negative të pjesëmarrjes publike (si protesta dhe demonstrata) sesa në ato pozitive (organizime në OJQ apo iniciativa qytetare). Në raportin e vitit 2006 pjesëmarrja e rinisë është përmirësuar ku çdo i katërti prej tyre ka marrë pjesë në nënshkrim të peticioneve ose iniciativave qytetare, por vetëm 4% nga ta kanë qenë të angazhuar në projekte të OJQ-ve. Shumica e spektrit të shoqërisë civile në Kosovë është i grumbulluar nëpër OJQ me orientim të caktuar qëllimor. Po ashtu ekziston një numër i organizatave sindikale të cilat synojnë të mbrojnë të drejtat e punëtorëve të një ose më shumë fushave të caktuara, e po ashtu ekzistojnë grupe interesi që funksionojnë ad hoc dhe përbëhen nga qytetarë të ndryshëm të mbledhur rreth ndonjë çështje të caktuar ose studentë/nxënës për ndonjë aktivitet të caktuar.

Në bazë të të dhënave nga Ministria e Shërbimeve Publike ekzistojnë me shumë se 4000 OJQ që figurojnë të regjistruara, ndërsa vlerësohet se diku rreth 400 syresh aktualisht janë aktive. Vërehet mungesë e bashkëpunimit në mes të OJQ-ve dhe bashkëpunimi kryesisht bëhet për të marrë ndonjë fond nga donatorët. Me gjithë mungesën e madhe të bashkëpunimit ndërmjet OJQ-ve, ku shumica e shohin njëra-tjetrën si konkurrent për fonde më shumë se sa aleat për evokim dhe lobim, ka edhe raste ku janë krijuar koalicionet të gjëra qëllim-mira (për shembull, Koalicioni i OJQV-ve REFORMA 2004 që kishte për qëllim ndryshimin e sistemit zgjedhor, koalicioni "Demokracia në Veprim" që kreu monitorimin e zgjedhjeve të fundit të mbajtura në Kosovë dhe CIVIKOS që është menduar të jetë një formë partneriteti në mes OJQ-ve dhe institucioneve qeveritare).

Një problem i madh për sa i përket funksionimit të OJQ-ve në Kosovë është kapaciteti i dobët vendor për të siguruar qëndrueshmëri, para së gjithash qëndrueshmëri financiare. Në anën tjetër, shpesh ndodh që qëllimi i OJQ-së ndryshon për t'ju përshtatur asaj çka kërkon donatori. Një çështje që

vlen të përshëndetet është hapësira mediale e kënaqshme që iu ofrohet iniciativave të OJQ-ve të ndryshme nga mediet kosovare¹. Përveç iniciativave të formalizuara përmes regjistrimit si OJQ ka edhe raste të iniciativave qytetare që janë të përkohshme dhe lidhen për ndonjë brengë të përbashkët të tyre (siç është iniciativa për mbrojtjen e godinës së kinemasë në Prizren, godinës së ish-Hotelit Union apo edhe forume elektronike të diskutimit siç është rasti i Prishtina Team-it).

Përfundimisht mund të vlerësohet se organizimi i shoqërisë civile në Kosovë është kaotik dhe shpesh herë duplikohen iniciativat dhe shprehet mungesë jo e vogël bashkëpunimi. Kjo mund të tejkalohet atëherë kur OJQ-të nuk e shohin njëra tjetrën si konkurrencte por si aleate në detyrën e përbashkët për mbrojtur të drejtat dhe interesat e qytetarëve.

2.3 Korniza teorike

Një nga parimet më të rëndësishme të zhvillimit lokal është pjesëmarrja. Në mënyrë që të dihet se pse është pjesëmarrja e rëndësishme në zhvillimin e komunitetit është e nevojshme që të shihet se si autorë të ndryshëm e definojnë atë. Definicioni më i thjeshtë për pjesëmarrjen është “të kesh pjesë, të marrësh pjesë, të kesh diçka nga” (Concise Oxford English Dictionary). Sidoqoftë, pjesëmarrja është diçka më komplekse, ajo nënkupton “gjëra të ndryshme për njerëz të ndryshëm, por në thelb ka të bëjë me përfshirjen në vendimmarrje, zbatim dhe monitorim të njerëzve që ndikohen nga këto vendime” (Warburton 1997, 7). Sipas Oakley (1991, 17) “pjesëmarrja ka të bëjë me zhvillimin njerëzor dhe rritjen e vetëdijes së qytetarëve në kontrollin e çështjeve që kanë të bëjnë me jetën e tyre, i ndihmojnë atyre si të planifikojnë dhe zbatojnë, në një kuptim me të gjerë, i përgatit ata për pjesëmarrje në nivel rajonal madje edhe kombëtar. Në thelb, pjesëmarrja është “një gjë e mirë” sepse i liron njerëzit nga izolimi dhe krijojnë kushte për ta që jo vetëm të kenë një ndikim thelbësor në zhvillim, por po ashtu një pavarësi më të madhe dhe kontroll mbi jetën e tyre”. Platt (1996) referohet në tri lloje të pjesëmarrjes së komuniteteve lokale dhe individëve:

- Pjesëmarrja fizike – prezenca, përdorimi i aftësive dhe përpjekjeve të dikujt;
- Pjesëmarrja intelektuale – konceptualizimi i aktivitetit, vendimmarrjes, organizimit dhe menaxhimit;
- Pjesëmarrja emocionale – marrja e përgjegjësisë, pushtetit dhe autoritetit.

Janë disa arsye pse pjesëmarrja është e rëndësishme për zhvillimin

1) Claussen, Kathleen. "Life Cycles of Civil Society and Civic Participation in Kosovo" Paper presented at the annual meeting of the The Midwest Political Science Association, Palmer House Hilton, Chicago, Illinois, Apr 20, 2006 Online <APPLICATION/PDF>. 2008-05-08 <http://www.allacademic.com/meta/p140039_index.html>

e komunitetit: ajo i shërben vendim-marrëseve për të gjetur se cilat janë preferencat e publikut, kështu që ata mund të kenë rol në vendimet e tyre; vendimet përmirësohen me marrjen në konsideratë të dijes lokale; pjesëmarrja e mbron barazinë dhe drejtësinë (Innes and Booher 2005, 422).

Ekzistojnë nivele të ndryshme të pjesëmarrjes. Në disa nivele njerëzit janë më pak të fuqishëm ndërsa më shumë në disa tjerë. Sherry Arstein (1969) ka përkrahur tetë nivele të pjesëmarrjes.

Niveli 1	Manipulimi	Këto nivele nënkuptojnë një komunitet pasiv, duke dhënë informata që mund të jenë të pjesshme dhe të gabueshme
Niveli 2	Arsimimi	
Niveli 3	Informimi	Njerëzve u tregohet se ç'është duke ndodhur, do të ndodhë apo ka ndodhur.
Niveli 4	Konsultimi	Njerëzve u jepet mundësia për të folur, por nuk ka mekanizma që garanton që pikëpamjet e tyre merren në konsideratë
Niveli 5	Përfshirja	Pikëpamjet e njerëzve kanë pak influencë, por mbajtësit tradicional të pushtetit akoma i marrin vendimet
Niveli 6	Partneriteti	Njerëzit mund të fillojnë të negociojnë me mbajtësit tradicional të pushtetit, duke përfshirë rolet e ndara, përgjegjësitë dhe nivelet e kontrollit
Niveli 7	Pushteti i deleguar	Pak pushtet është i deleguar
Niveli 8	Kontroli qytetar	Delegim i plotë i tërë vendimmarrjes dhe veprimit

2.4 Praktika kosovare e pjesëmarrjes

Niveli i pjesëmarrjes së komunitetit në Kosovë është mjaft i ulët. Arsyet janë të ndryshme dhe në vijim të këtij punimi do të diskutohen disa nga to. Një prej arsyeve kryesore se pse komuniteti në Kosovë nuk është shumë aktiv është fakti që Kosova është duke kaluar nëpër një fazë të tranzicionit socio-politik, sikurse edhe ekonomik. Në sistemin e kaluar komunist komuniteti

ka qenë mjaft pasiv dhe vendimet gjithmonë kanë ardhur nga lartë duke mos marrë për bazë fare mendimet që vijnë nga poshtë. Nëse i referohemi teorisë së Arstein, atëherë kjo nënkupton që gjatë sistemit të kaluar, niveli i pjesëmarrjes së qytetarëve në Kosovë ka qenë në nivelin e parë – atë të manipulimit.

Pas luftës së vitit 1999, niveli i pjesëmarrjes së komunitetit në Kosovë mund të thuhet që ka variuar në nivele të ndryshme, varësisht nga lloji i çështjes që ka kërkuar pjesëmarrje, por duke qëndruar kryesisht në nivele të ulëta. Kjo ka ndodhur për disa arsye të ndryshme, ku rolin kryesor e ka pasur përfshirja e shumë aktorëve të nivelit vendor dhe atij ndërkombëtar. Gjatë periudhës së rindërtimit emergjent, Kosovën e vërshuan me dhjetëra organizata ndërkombëtare të cilat zbatuan me qindra projekte të rindërtimit. Gjatë kësaj faze mund të thuhet që komuniteti në Kosovë nuk ka qenë i përfshirë fare në procesin e vendim-marrjes – kanë qenë vetë këto organizata donatore të cilat kanë vendosur se çfarë projektesh do të zbatojnë. Duke pasur parasysh nevojën e riparimit sa më të shpejtë të pasojave të shkaktuara nga lufta, kosovarët nuk i kundërshtuan këto projekte, edhe pse ata nuk pyeteshin fare se a janë ato projekte me prioritet për ta. Pas përfundimit të periudhës emergjente u pa që shumë nga ato projekte që ishin zbatuar pa marrë asnjë mendim nga komuniteti për të cilin ato ishin destinuar, sollën pak sukses.

Fatkeqësisht edhe pse faza emergjente e rindërtimit ka kaluar dhe tani më ekzistojnë organet e shtetërore si të nivelit qendror e po ashtu edhe të atij lokal, niveli i pjesëmarrjes së komunitetit në Kosovë le akoma për të dëshiruar. Komunitetet, por edhe institucionet shtetërore akoma nuk janë të vetëdijshëm për rolin që mund dhe duhet ta ketë komuniteti në procesin e vendim-marrjes për çështjet që kanë të bëjnë me çështjet jetike të tyre. Institucionet shtetërore bëjnë pak përpjekje për përfshirjen e komunitetit në procesin e vendim-marrjes, përderisa komunitetet nuk i besojnë aspak atyre pak përpjekjeve që bëhen nga institucionet.

Një faktor tjetër që ndikon në pjesëmarrjen e ulët të komunitetit është edhe keqkuptimi i vetë nocionit pjesëmarrje. Kur flitet për nocionin “pjesëmarrje”, zakonisht qytetarët mendojnë në pjesëmarrjen financiare që zakonisht qytetarët duhet t’a bëjnë në të gjitha projektet që zbatohen nga qeveria lokale në komunitetin e tyre. Një gjë e tillë tregon se qytetarët janë shumë pak të informuar për rolin e tyre në procesin e vendim-marrjes në nivelin lokal. Mos informimi i saktë dhe i duhur është një faktor tjetër më vete që ndikon në nivelin e ulët të pjesëmarrjes. Neni 8 i rregullores 2007/30 e cila ka ndryshuar rregulloren 2000/45 mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës, i obligon komunat që së paku dy herë në vit të organizojnë tubime publike me qytetarët. Edhe pse në përgjithësi komunat e respektojnë një obligim të tillë, pjesëmarrja e qytetarëve në këto tubime është shumë e vogël, të cilat shpesh mbahen vetëm me praninë e personelit administrativ të komunave. Një pjesëmarrje e ulët e qytetarëve në këto mbledhje publike mund të shpjegohet me besimin e ulët që kanë qytetarët në atë se mendimet e tyre do të merren në konsideratë nga ana e organeve të qeverive lokale.

2.4.1 Brekoci – shembull i pjesëmarrjes dhe mobilizimit të komunitetit²

Edhe pse më lart u tregua që niveli i pjesëmarrjes së komunitetit në Kosovë është në nivel të ulët, ka edhe raste ku pjesëmarrja dhe përfshirja e komunitetit bëhet në mënyrë të plotë. Një nga këto raste të rralla në Kosovë është shembulli i një vendbanimi jo formal – Brekocit.

Ministria për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor e Kosovës (MMPH) ka hartuar një udhëzues për planifikim hapësinor të vendbanimeve jo formale. Sipas këtij udhëzuesi, vendbanimet joformale janë konsideruar vendbanimet në të cilat banorët nuk i gëzojnë të drejtat për banim adekuat dhe ato mund të dallohen në bazë të këtyre karakteristikave kryesore: zotërimi jo formal ose jo i sigurt i pronësisë; infrastruktura joadekuat; mjedisi jo i shëndoshë, dendësia e pakontrolluar e popullsisë, banimi jo i përshtatshëm, etj. Brekoci ka qenë një nga vendbanimet që është karakterizuar si jo formal së bashku me dy vendbanime tjera në komunën e Gjakovës (Koloninë dhe Dardaninë).

Brekoci është një lagje në qytetin e Gjakovës që ka rreth 650 banorë me 110 shtëpi banimi. Rreth 71% e popullatës në këtë lagje janë të komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian (RAE) ndërsa pjesa tjetër të komunitetit shqiptar. Vetëm 25% e popullatës së Brekocit janë të punësuar.

Për të bërë aplikimin e udhëzuesit të lartpërmendur për planifikim hapësinor të vendbanimeve joformale, MMPH, financuar nga Fondi për Zhvillimin e Komunitetit (CDF) zgjodhën pikërisht vendbanimin e Brekocit. Për ta siguruar pjesëmarrjen sa më të mirë të komunitetit në këtë projekt, CDF-ja, përveç tjerash, ka organizuar katër takime publike me komunitetin e Brekocit. Në takimin e parë është bërë informimi i komunitetit mbi projektin; në takimin e dytë është bërë zgjedhja e çështjeve prioritare për komunitetin; në takimin e tretë është bërë vlerësimi i skenarit më të mirë të zhvillimit; në takimin e katërt është bërë vlerësimi i përbashkët të planit të lagjes.

Me anë të këtij procesi është arritur organizimi, përkatësisht përfshirja e komunitetit, realizimi i projektit të qendrës së komunitetit, bashkëpunimi ndër-institucional (përveç ministrisë, CDF dhe komunitetit po ashtu kanë qenë të përfshira edhe institucionet e nivelit lokal), si dhe është bërë hartimi i planit rregullues urban për vendbanimin e Brekocit, bazuar në kërkesat e banorëve. Rezultatet e arritura në këtë projekt pilot kanë shërbyer si shembull në zbatimin e udhëzuesit për planifikim hapësinor të vendbanimeve jo formale edhe në qytetet tjera. Rasti i Brekocit është një shembull i cili më së miri tregon mundësinë e përfshirjes në vendim-marrje të komunitetit, institucioneve lokale dhe qendrore, si dhe donatorëve në projekte më interes për komunitetin.

² Në mbledhjen e informacioneve për këtë pjesë të këtij punimi ka kontribuar znj. Vjollca Çavolli, Përgjegjëse për Promovim dhe Shërbime Sociale, CDF.

2.4.2 Shembuj tjerë të përfshirjes së komunitetit

Një shembull tjetër i mirë i pjesëmarrjes së komunitetit, sipas një raporti të UNDP-së, është konsideruar hartimi i Strategjisë dhe Planit Zhvillimor të Kosovës 2007-2013 që është përgatitur nga një sekretariat i posaçëm në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës. Përgatitja dhe hartimi i strategjisë iu besua tri grupeve: Grupit të rrjetit të shoqërisë civile, Grupit makroekonomik dhe Grupit teknik. Procesi i hartimit dhe përzgjedhjes së politikave prioritare kaloi nëpër një proces të gjerë konsultimesh me organizata nga shoqëria civile si dhe me organizatat ekzistuese rinore. Rrjedhimisht, në shtatë rajone të Kosovës, çka siguroi mbulimin e tërë territorit të Kosovës u organizuan mbi 65 tryeza diskutimi me grupe të shoqërisë civile, dhjetë nga to me grupe të minoritetit serb. Secili grup debati ka diskutuar për një numër të caktuar çështjesh duke përfshirë bujqësinë, zhvillimin rural, biznesin, arsimin, shëndetësinë, kulturën, të drejtat e njeriut, infrastrukturën dhe rininë. Në këtë mënyrë janë nxjerrë prioritetet për secilin rajon dhe kjo është kthyer në një grup politikash nacionale me prioritetet e diktuar nga shoqëria civile³. Kjo mund të konsiderohet si nisma më serioze e institucioneve të Kosovës për përfshirjen e shoqërisë civile në procesin e hartimit të politikave të zhvillimit, por për sa i përket implementimit të kësaj strategjie mbetet shumë për tu dëshiruar.

Raste të tjera të përfshirjes dhe mobilizimit të komunitetit edhe pse me organizime jo formale janë edhe: Iniciativa për mbrojtjen nga rrënimin të ndërtesës së ish - Hotel Unionit dhe Kinemasë së qytetit të Prizrenit, objekte këto të cilësuar nga komuniteti si objekte me vlera të veçanta arkitektonike dhe tradicionale. Të dy këto iniciativa kanë arritur që së paku përkohësisht të ndalojnë rrënimin e këtyre objekteve. Këto iniciativa kanë arritur që të vetëdijësojnë institucionet lokale që mos të ndërmarrin veprime pa përfshirje të komunitetit të cilin e prekin ato veprime, sikurse edhe kanë arritur që të vetëdijësojnë komunitetin për mënyrat e ndryshme për të pasur ndikim në procesin e vendimmarrjes.

Përfundime dhe rekomandime

Bazuar në atë që u tha më lart mund të konkludohet se niveli i pjesëmarrjes dhe mobilizimit të komunitetit në Kosovë nuk është i kënaqshëm, dhe ai ndryshon nga rasti në rast, por duke qenë kryesisht në nivele të ulëta. Arsytet për një gjë të tillë janë të shumta. Mungesa e traditës së pjesëmarrjes, mungesa e informacionit për rëndësinë e pjesëmarrjes, mosgatishmëria e

3) Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP). Raporti i Zhvillimit Njerëzor i Kosovës (RZHNIK 2006)- Një gjeneratë e re për një Kosovë të re, Prishtinë. 2007.

institucioneve shtetërore për angazhim të komuniteteve, etj., janë disa nga faktorët që kanë ndikuar për të pasur një situatë të tillë.

Në mënyrë që niveli i pjesëmarrjes së komunitetit të rritet, është e nevojshme që të ndërmerren hapat në vijim:

Të rregullohet në mënyrë ligjore e drejta e pjesëmarrjes aktive të komunitetit në proceset e vendim-marrjes;

Të organizohen fushata për të ngritur vetëdijen e komunitetit për rëndësinë e pjesëmarrjes dhe rolin që mund të kenë në procesin e vendim-marrjes;

Të ngrihet vetëdija e përfaqësuesve të institucioneve që pjesëmarrja e komunitetit në hartimin e politikave e bën më të lehtë zbatimin e tyre;

Të jepen më shumë donacione më qëllim që të ndihmohet për t'u krijuar një kulturë pjesëmarrje më aktive e komunitetit në çështjet që lidhen drejtpërsëdrejti me ta.

Bibliografia

CIA the World Factbook. <https://www.cia.gov/library/publications/the-world-factbook/geos/ko.html>

Claussen, Kathleen. "Life Cycles of Civil Society and Civic Participation in Kosovo" Paper presented at the annual meeting of the The Midwest Political Science Association, Palmer House Hilton, Chicago, Illinois, Apr 20, 2006 Online <APPLICATION/PDF>. 2008-05-08 http://www.allacademic.com/meta/p140039_index.html

Commission of the European Communities. Kosovo- under UNSCR 1244-2007 Progress Report, Brussels, 6.11.2007

Community Development Fund. www.kcdf.org

Enti i Statistikave të Kosovës. <http://www.ks-gov.net/esk/>

Kuvendi i Kosovës. <http://www.kuvendikosoves.org/>

Meldon, Dr. Jeanne and Kenny, Mr. Michael and Walsh, Professor Jim. 2002. Local Government, local development and citizen participation , in Decoster, Dominique-Paule, Eds. . Universite Libre de Bruxelles. (online), Available: http://eprints.nuim.ie/archive/00000272/01/Paper_on_Local_Government_Draft.doc#_Toc499023667

UNMIK. 2007. Rregullore Nr. 2007/30 për ndryshimin e rregullores Nr. 2000/45 mbi vetëqeverisjen e komunave në Kosovë. http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/A2007regs/RA2007_30_revised.pdf

UNDP Kosovë. <http://www.kosovo.undp.org/?cid=2,42>

Warburton, Diane. 1997. Participatory Action in the Countryside (online), available: http://www.sharedpractice.org.uk/Downloads/Participatory_Action_Review.pdf (accessed 4th of March 2008)

Wilcox, David. 1994. The guide to effective the participation (online), available: <http://www.partnerships.org.uk/guide/partguide.zip> (accessed 4th of March 2008)

**Praktikat e Mira nga Maqedonia
Mobilizimi i Bashkësive dhe Pjesëmarrja e Qytetarëve në Vetëqeverisjen
Lokale**

Tanja Hafner-Ademi

Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar, MCIC

Hyrje

Ky raport i shkurtër ka për qëllim të paraqesë shembujt e deritanishëm pozitivë në zgjidhjen e problemeve të qytetarëve në Republikën e Maqedonisë si dhe të ofrojë përfundimet e nxjerra prej tyre mbi pengesat kryesore, sfidat dhe mësimet e përftuara.

Raporti është i ndarë në tre pjesë. Në pjesën e parë janë prezantuar dy raste studimi të mobilizimit të qytetarëve. Në pjesën e dytë janë prezantuar rezultatet nga studimi i marrëdhënieve mes njësisive të vetëqeverisjes lokale (NJVL) dhe organizatave qytetare (OQ), si shembulli më i shpeshtë i organizimit të qytetarëve në zgjidhjen e problemeve në bashkësi. Pjesa e tretë ka të bëjë me përfundimet mbi pengesat kryesore, sfidat dhe mësimet e nxjerra nga përvojat e paraqitura në kapitullin e parë dhe të dytë, me qëllim që të shihen si modele dhe struktura të mundshme në mobilizimin e bashkësive apo pjesëmarrjen qytetare në vetëqeverisjen lokale në Maqedoni.

Ky raport parimisht është i bazuar në përvojat e Qendrës Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (QMBN), një nga organizatat kryesore qytetare në vend, e cila punon në këtë fushë me qëllim që t'i ndajë ato pa pretendimin e të qenit gjithëpërfshirëse apo të vetme.

3.1 Raste Studimi të Organizimit Qytetar

Në këtë pjesë janë prezantuar dy raste studimi mbi mobilizimin e qytetarëve në Maqedoni. E para përshkruan shembullin e organizimit të personave me handicap në komunën e Dibrës në bashkëpunim me organizatën humanitare “Meseçina”, me qëllim zgjidhjen e nevojave të tyre ekzistenciale dhe shoqërore, si regjistrimi, trajnimi, punësimi dhe shoqërimi mes tyre. Në studimin e dytë bëhet fjalë për organizimin e ngjashëm të qytetarëve nga fshati Sërbicë, me qëllim zgjidhjen e problemeve të lidhura me jetesën e tyre në fshat si dhe kushtet themelore, si për shembull ndërtimi i një ujësjellësi.

3.2 Klubi i Personave Handikapë në Dibër

Mobilizimi i bashkësisë u bë me nismën lokale të disa individëve, të cilët në bashkëpunim me OJQ-në "Meseçina" në Dibër disa vjet më parë vunë re gjendjen shumë të vështirë të personave handikapë, veçanërisht të personave të paralizuar, të cilët në atë rajon janë të izoluar dhe të përjashtuar nga jeta e përditshme. Disa nga këta individë në mënyrë të drejtpërdrejtë janë të lidhur me problemin e handicapit ose kanë patur persona të afërt të cilët janë ballafaquar me një problem të tillë. Sistemi shëndetësor dhe social nuk siguron mundësi për ndihmë për këta persona dhe mbi të gjitha nuk ofron asgjë për integrimin e tyre social. Ky ishte motivimi kryesor për disa entuziastë qëllim-mirë të cilët vunë kontakt së pari me OJQ-në "Meseçina", të cilët me përvojën dhe njohuritë e tyre arritën të mobilizojnë mjete dhe të mira materiale për realizimin e suksesshëm të projektit.

Falë kësaj nisme, më shumë se treqind persona handikapë dhe invalidë nga Dibra dhe rrethinat, fituan këshillimorën e tyre ku do të mund të shoqërohen por edhe të shfrytëzojnë shërbimet përkatëse. Gjendja e vështirë në të cilën gjendeshin këta persona, situata e pavolitshme ekonomike, e cila nuk u mundësonte të mbulonin shpenzimet themelore për pajisje dhe vizitë mjekësore, ishin faktorët që e vështirësuan miratimin e vendimit që të punohet në këtë sferë.

Me qëllim ardhjen në ndihmë të këtij grupi, u përgatitën pyetësorë për identifikimin dhe regjistrimin e personave handikapë. Plotësimi i pyetësorëve filloi në vitin 2000 në territorin e qytetit të Dibrës, fshatrat e Qendrës Zhupë dhe fshatrat nga rajoni i komunës së Rostushes. Të dhënat nga pyetësorët u futën në bazën e informatave, ku ishin regjistruar më shumë se 300 persona. Paralelisht me identifikimin e personave handikapë dhe invalidëve u bë edhe shpërndarja e pajisjeve për ta (40 karroca për invalidë, 50 paterica, 20 dyshekë dhe mbi 12.000 pelena në vlerë prej 4.327.600 denarë). U formua klubi i personave handikapë dhe invalidëve për rajonin e Dibrës dhe u siguroa minibusi dhe pajisje të tjera të nevojshme që do të mundësojnë socializimin e tyre dhe inkuadrimit në bashkësi. Nisma pozitive dhe qasja e mirë siguroi interesim të madh të mediave dhe pushtetit lokal, çka e bëri edhe më të suksesshëm këtë projekt.

3.3 Së shpejti ujësjellës në fshatin Sërbicë

Banorët e fshatit Sërbicë nevojën për ujë e plotësonin nga bunarët e tyre që janë me kapacitet të pamjaftueshëm dhe me cilësi të dobët uji. Dendësia e popullatës dhe mungesa e sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit sollën deri tek përzierja e ujërave të zeza me ujin e pijshëm. Në afërsi të fshatit gjendet edhe termocentrali Oslomej, që ndikon në cilësinë e ujit nga bunarët. Si rezultat i kësaj, gjatë 10 viteve të fundit janë shpërngulur 57 persona.

Problemi u bë dramatik me fillimin e krizës kosovare kur në fshat u pranuan 210 refugjatë, pra rreth 12,5% të numrit të përgjithshëm të banorëve në fshat.

Liderët e bashkësisë së fshatit disa vite më parë ishin përpjekur t'i mobilizonin fshatarët si dhe të gjithë të emigruarit jashtë vendit, me qëllim zgjidhjen cilësore të problemit. Së pari u formua këshilli iniciues, i cili ishte përgjegjës për realizimin e gjithë projektit. Në grupin iniciues u inkuadruan 9 persona të cilët paraqesnin vlera të ndryshme (persona të arsimuar, të moshuar, me përvojë, persona nga xhamia, nga shkolla, nga lagje të ndryshme të fshatit). Në këtë mënyrë u siguroa se të gjithë interesat dhe nevojat do të përfaqësoheshin në mënyrë të barabartë. Të gjithë këta persona nga këshilli iniciues kishin një rol përkatës. Dikush ishte përgjegjës për kontakte me komunën dhe donatorët, dikush për nevojat teknike (përpunimi i projektit, sigurimi i lejeve të nevojshme për ndërtim etj.), dikush për mobilizimin e mjeteve nga donacionet bamirëse nga diaspora, dikush për organizimin e banorëve për dhënien e vetë kontributit.

Mjetet e para të grumbulluara nga vetë kontributi (një pjesë) u përdorën për përpunimin e projektit. Në bazë të projektit u vlerësua se sa mjete duhet të siguroheshin për ndërtimin e ujësjellësit. Në këtë mënyrë mund të përgatitej plani për mobilizimin e mjeteve, ku pjesa më e madhe ishte siguruar nga emigrantët. Këshilli iniciues mori vendim për grumbullimin e mjeteve nga çdo familje dhe të gjitha familjet u vizituan duke i informuar qartë për gjithë procedurën dhe mënyrën e realizimit. Gjithashtu u vendos që familjet më të varfra të mos paguanin kontribut.

Këshilli iu drejtua QMBN-së me kërkesë për ndihmë financiare për përgatitjen dhe realizimin e projektit për përmirësimin e furnizimit me ujë në fshat. QMBN kështu u bashkëngjiti në ndërtimin e mirë organizuar të rrjetit të ujësjellësit në Sërbicë nga ana e vetë fshatarëve.

3.4 Inkuadrimi i qytetarëve në vetëqeverisjen lokale

Në këtë pjesë të raportit janë prezantuar rezultatet nga studimi i marrëdhënieve mes njësive të vetëqeverisjes lokale (NJVL) dhe organizatave qytetare (OQ), si shembulli më i shpeshtë i organizimit qytetar në zgjidhjen e problemeve në bashkësi. Studimi u realizua në vitin 2007 dhe u publikua në dhjetor të vitit të njëjtë nga ana e QMBN në bashkëpunim me Studiorum. Gjerësisht hulumtimi është pjesë nga aktivitetet e Platformës Qytetare të Maqedonisë (PQM), e cila në programin e saj për periudhën 2006-2007 parashikoi aktivitete për informimin në kohë të administratës lokale dhe i prezantoi modelet e mbështetjes së organizatave qytetare nga NJVL, në procesin e decentralizimit.

Ky hulumtim është realizuar në 10 pilot komuna të zgjedhura¹, mes anketimit të përfaqësuesve të NJVL dhe OQ, aktive në komunën përkatëse, si dhe biseda me ekspertë nga fusha të shoqërisë civile dhe vetëqeverisjes lokale. Në këtë hulumtim janë marrë parasysh aktivitetet dhe projektet nga kjo fushë, të cilat në atë kohë janë zbatuar nga ana e donatorëve të ndryshëm, si për shembull projekte të Agjencisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Agjencia Evropiane për Rikonstruim (EAR), Ambasada e Zvicrës, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), të cilat kanë për qëllim të rrisin kapacitetet e NJVL dhe të OQ dhe të nxitin modele dhe praktika të reja të institucionalizuara të bashkëpunimit.

Megjithë mundësinë ligjore, por edhe obligimin për miratimin e akteve të caktuara në nivel lokal, pjesa më e madhe e NJVL në Maqedoni akoma nuk kanë përpunuar ose miratuar rregullore për bashkëpunim me sektorin civil. Për adresimin e këtij problemi, rekomandohet rregullimi juridik i bashkëpunimit me sektorin civil, përpunimi i formularëve të standardizuar për aplikim dhe memorandum për bashkëpunim nga ana e NJVL, por edhe ofrimi i ekspertizës për përpunimin e këtyre dokumenteve (atje ku ekziston) nga ana e OQ.

Informimi i ndërsjellë i njësive të vetëqeverisjes lokale dhe organizatave qytetare për aktivitetet e tyre kryesisht zhvillohet mes organeve të NJVL, gjerësisht mes mediave, si dhe në masë të madhe me iniciativë të OQ, të cilat dëshirojnë të bashkëpunojnë me NJVL. Si rezultat i mosekzistimit të mekanizmave për informim, pothuajse sipas rregullës, NJVL nuk posedojnë bazë të dhënave të OQ të regjistruara ose aktive në komunën përkatëse. Kjo mund të tejkalohet me disa masa të thjeshta, siç është vendosja e listës së e-mailit për informimin e OQ dhe postimin e informatave për OQ në ueb-faqet e NJVL, por edhe me përpunimin dhe azhurnimin e data bazës së organizatave aktive qytetare; OQ, mund të kontribuojnë për informimin e mirë me informimin e rregullt për punën e tyre, në formë të raporteve vjetore dhe programeve për punë, ose formimin e trupit koordinues të OQ për njohjen më të mirë mes tyre.

Bashkëpunimi formal mes NJVL dhe OQ është e rregulluar në disa mënyra: Departamenti ose Komisioni për bashkëpunim, Qendra për informim të qytetarëve dhe/ose personi i caktuar për bashkëpunim me sektorin civil, ose drejtpërdrejt me drejtorinë komunale. Në ato komuna ku nuk ekziston zgjidhje adekuate për bashkëpunim, rekomandohet vendosja e organit formal, si dhe shfrytëzimi më i madh i ekspertizës dhe shërbimeve të OQ, në identifikimin dhe adresimin e problemeve dhe nevojave të qytetarëve, bashkëpunimi në përpunimin e dokumenteve strategjike dhe dokumenteve tjerë të nevojshëm për punën e NJVL dhe komunikimin e përmirësuar me qytetarët.

Në pajtim me Ligjin për njësitë e vetëqeverisjes lokale, komunat në buxhetin e tyre duhet të parashohin mjete për financimin e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve në miratimin e vendimeve në komuna, dhe atë

¹) Shkup, Karposh, Dibër, Ilinden, Sveti Nikole, Zhelinë, Vrapçishtë, Kriva Palankë, Manastir, Berovë.

në formë të iniciativave qytetare, tubimeve të qytetarëve dhe referendumeve. Lidhur me mbështetjen financiare të OQ, pothuaj të gjitha komunat që ishin lëndë e hulmtimit kanë paraparë nën shkallë në buxhetin e tyre

Lidhur me mbështetjen financiare të OQ, pothuaj të gjitha komunat të cilat ishin lëndë e hulmtimit kanë paraparë nën shkallë në buxhetin e tyre për financimin e aktiviteteve të OQ. Shuma e kësaj shkalle dhe mënyra e shpërndarjes janë të ndryshme nëpër komuna; në përgjithësi, nuk ekziston sistem i unifikuar i aplikimit e as procedurë e vetme e evoluimit të propozim projekteve të parashtruara dhe iniciativave, ndërsa edhe në të shumtën e rasteve, për mjetet e miratuara nuk nënshkruhet marrëveshje për bashkëpunim, për çka nuk ekziston obligim formal i OQ për të raportuar për mënyrën dhe dinamikën e shfrytëzimit të mjeteve të fituara. Për këtë çështje, krahas rekomandimeve për vendosjen e formularëve standard dhe kriteve për evoluim, propozohet edhe vendosja e praktikave inovative të grumbullimit të mjeteve për mbështetje financiare të OQ, si për shembull ndarja e një pjese nga dënimet me të holla ose taksat për ndotjen e ambientit jetësor, të cilat do të shfrytëzoheshin për qëllime të caktuara.

Përveç sfidës së sigurimit të mjeteve financiare, OQ ballafaqohen edhe me probleme të tjera, të cilat ua vështirësojnë punën; më së shpeshti theksohet mospasja e zyrave për punë, trajnimi i pamjaftueshëm për të shkruar projekt-propozime ose për aplikimin e fondeve të caktuara dhe mungesa e kuadrove me njohjen e gjuhës angleze. Një nga rekomandimet për zgjidhjen e këtij problemi është bashkëpunimi në bazë partneriteti me aplikimin për mjete nga donatorë të tjerë, për realizimin e aktiviteteve me interes të përbashkët. Gjatë kësaj, bashkëpunimi i tillë nuk do të ishte vetëm deklarativ, por edhe me investim të përbashkët. Në këtë mënyrë, do të sigurohej pronësi më e madhe për aktivitetet dhe rezultatet nga projektet e realizuara.

Lidhur me pjesëmarrjen e OQ në punën e organeve të NJVL, ekziston një mendim i pranuar nga të gjithë se OQ duhet të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit, e bile edhe të kenë përfaqësues të tyre në Këshill që ta shohin më me rëndësi pjesëmarrjen e tyre në punën e komisioneve në organet komunale. Lidhur me përgatitjen e NJVL për delegimin e një pjese të kompetencave të sektorit civil, një pjesë e komunave në këtë fazë nuk mendojnë aspak ose nuk kanë qëndrim për këtë çështje.

Përfundime, leksione të mësuara dhe rekomandime

Në këtë pjesë janë prezantuar përfundimet për pengesat kryesore, sfidat dhe leksionet e mësuara nga përvojat e prezantuara në kapitullin e parë dhe të dytë me qëllim që të shihen modelet dhe strukturat e mundshme në mobilizimin e bashkësisë ose pjesëmarrjen e qytetarëve në vetëqeverisjen lokale në Maqedoni.

Në bazë të rasteve të studimit dhe hulumtimeve mbi inkuadrimin e qytetarëve në punën e vetëqeverisjes lokale nëpërmjet OQ, mund të sillen përfundimet në vijim e sipër:

- Ekzistojnë shembuj të vetë-iniciativës dhe vetë-organizimit të qytetarëve për zgjidhjen e problemeve të tyre;
- Ata më së shpeshti janë të suksesshëm nëse vetë-iniciativa dhe vetë-organizimi (që sjell pronësinë e bashkësisë dhe qëndrueshmërinë e zgjidhjes) lidhen me shoqata me përvojë të qytetarëve/OQ, të cilat mund të japin mbështetje eksperte (si dhe mbështetje financiare) për zgjidhjen e problemeve të tyre;
- Bashkëpunimi NJVL-OQ ekziston në një nivel të caktuar, por jo edhe në nivel të duhur. Gjithsesi kuadri është i larmishëm dhe heterogjen.

Si pengesa më të shpeshta në mobilizimin e suksesshëm të bashkësive paraqiten:

- Mospasja e fondeve (financave) për kompletimin e tërësishëm të iniciativës (projektit);
- Akoma ekziston shprehia e vjetër se dikush tjetër duhet ta zgjidhë problemin (dikush tjetër është përgjegjës për atë, e si "fajtor" më i shpeshtë paraqitet shteti);
- Besimi i humbur dhe jo gatishmëria për bashkëpunim të përbashkët;
- Ndarja e brendshme e bashkësisë në realizimin e iniciativës (partiake, nga interesi, mentaliteti);
- Fryma e vullnetarizmit gradualisht humbet dhe nuk mundëson zgjidhjen e problemeve të bashkësisë me inkuadrimin aktiv të banorëve nga vetë bashkësia;
- Mospasja e njohurive si të fillohet iniciativa, formimi i këshillit iniciues, përgatitja e projekt propozimeve, fillimi i bashkëpunimit me autoritetet lokale dhe partnerët tjerë për mbështetje.

Si kushte për mobilizimin e suksesshëm paraqiten:

- Pjesëmarrja personale dhe pjesëmarrja në procesin e iniciativës;

- Vendosja me kohë e modelit për menaxhim dhe qëndrueshmëri të iniciativës së realizuar;
- Të vendoset “pronësi” e iniciativës dhe të mos udhëhiqet nga dikush tjetër;
- Inkuadrimi i personave me ndikim me besim në iniciativën e vetë bashkësisë;
- Bashkëpunimi me pushtetin lokal dhe qendror;
- Inkuadrimi dhe mbështetja nga OQ;
- Rezultatet e mira të mëparshme nga iniciativat lokale (referencë e mirë dhe rezultate që mundësojnë besim për mobilizimin e fondeve).

Regional Best Practices on Community Participation in the Local Governance Decision-Making Process

Summary

Regional Best Practices on Community Participation in the Local Governance Decision-Making Process

Institute for Democracy and Mediation –IDM¹, has been for a long time working closely with local government and civic structures throughout Albania struggling to promote participatory governance at the local level. Following the preparation of a particular theoretical and operational foundation for the elaboration of specific schemes of community mobilization through the set up of Community Based Groups and the promotion of the Community Liaison structure, IDM is encouraging local government to build linking and interactive bridges with the citizens.

The Community Liaison structure is a sustainable model that involves citizens in the agenda setting process. This structure is based on a archetypal Albanian practice and is already operating in the cities of Tirana and Shkodra. IDM's department of local mobilization and decentralization in cooperation with the Albanian Ministry of Interior² is encouraging local governments throughout Albania to institutionalize this structure that as such would stand between the citizens and local structures for the mobilization and organization of community; development of local partnerships and stimulation of dynamic interaction. Indeed this model has already been introduced successfully in the city of Durrës and with substantial contribution of the Municipality itself.

Community Based Groups (CBGs) represent another efficient tool leading to participatory governance and greater civic involvement in the local policy and decision making processes. IDM has a long experience in the field and has so far successfully implemented various related projects in the cities of Laç, Bajram Curri and Shkodra. The successful impact of these projects has already laid down the basis for further action by IDM in a genuine struggle to increase public support and strengthen partnerships with local government

1) For more information on IDM, please refer to our website: www.idmalbania.org

2) On this purpose, IDM's Executive Director and the Deputy Minister of Interior have signed a joint letter which guides local government representatives to include the CL position on their structures, as a useful and efficient means for local democracy.

representatives for a major policy development in this context, both in Albania and in the region.

Certainly due to the very similar socio-economic background that Albania has with other countries in the region in terms of past legitimacy, current problematique and future challenges, these good practices of participatory governance and community mobilization may well serve in neighboring countries as well, of course if adopted to the respective contexts and cultural premises of the communities themselves.

Basing on Kosovo report for instance, we may conclude that the level of participation and community mobilization in the country is not satisfactory and although it manifests some sporadic changes it still remains at very low levels. Lack of participatory tradition, lack of information regarding importance of participation and inclusion in the decision-making, unwillingness of public institutions to engage the communities in the agenda making process are only some of the factors bringing about the overall apathetic situation.

The report concludes that if a more active citizens' participation in governance is to take place in the country than several measures should be taken at the legislative and awareness raising level. Hence, initially there should exist a legislative basis ensuring the community's active participation in the decision-making process. Accordingly the process should be accompanied with a twofold awareness raising campaign. One hand the community itself should be awoken on the important role it can play in the agenda-setting process and on the other hand awareness raising work should be done also with local public institutions representatives in order for them to fully recognize that a more active citizens' participation in the policy elaboration would eventually facilitate their efficient and sustainable implementation.

A more or less similar situation is manifested in Macedonia. Basing on case studies disclosed in the Macedonia report on citizens' inclusion in the local decision-making process there are some examples of community participation, however they only become successful when supported by NGOs. Furthermore cooperation between the later and the Local Governance Units is not ample. The report identifies the following as obstacles to the successful mobilization of the community: lack of common ownership in the community's problem solving practice, lack of trust and unwillingness to cooperate, absence of know-how on community mobilization and cooperation with local structures or other local stakeholders.

This publication represents a regional initiative aiming at sharing IDM's best practices in the field of community participation and building participatory (local) governance through Community Liaisons and Community Based Groups. During the past years IDM has implemented various projects on this problematique and its experience has proved that community structures are essential for achieving sustainable impact in building participatory governance. Particularly the experience of Shkodra through community based groups and Durrës through Community Liaisons, offers a sound model of how the community can interact with local government, bring citizens' concerns

closer to local authorities and accordingly influence local decision making processes.

Furthermore, basin on up to now experience, community participation and mobilization schemes as well as tools that address the gap between the community and local government are particularly effective in multiethnic and multi-cultural societies, as it is the case of Kosovo and Macedonia. As these countries are characterized by a large diversity of population, consisting of various ethnic and linguistic minority groups, IDM considers the model of Community Liaison and the various schemes of community mobilization through specific interest groups as extremely relevant to the above-mentioned context.

Indeed the above mentioned schemes and structures deriving from their elaboration serve not only to the facilitation of communication among Community, Local Governance, Business and various Interest Groups, but at the same time in multi-ethnic societies can help reduce conflict and improve law enforcement. It is through such insight that this publication should be seen and understood, as a give-and-take address between neighbors, as joint effort among local homologue stakeholders for the further regional development and expansion of original models for enhanced participatory governance.